



Pranimi / Datedur Prilaps / Recd Registruar / Delivered	13-02-2023	3	viti / year
Organizimi / Organ / Entity	Pr. / Prof. No.	Shënimi / Prilog / Appendix	Sasia / Kohëzgjatja / Quantity
SKMST/OK	1729/2023		116



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1187/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Zyle Millaku Gojnovci- Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1187/2022 të datës 14.12.2022, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi:

kundër Vendimit me numër Ref:63/2022 me numër protokolli 2022/ZDP/361 të Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil, të datës 21.11.2022, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 13.02.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa A.nr.1187/2022 e datës 14.12.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. ANULOHET Vendimi me numër Ref:63/2022 me numër protokolli 2022/ZDP/361 i datës 21.11.2022 i Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës dhe Akt emërimi AE.Nr.02/2022 i datës 30.11.2022 si dhe çdo akt administrativ që rrjedh nga pasojat e këtij vendimi.

III. MBETET në fuqi Vendimi me numër Ref:55/2022 i me numër protokolli 2022/ZDP/308 i datës 04.10.2022 i Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës.

IV. OBLIGOHET Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të kthejë ankuesin në vendin e punës sipas Akt-it të Emërimit të datës 30.04.2013, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës si dhe të bëjë kompensimin e diferencës së pagës nga data 21.11.2022 deri në zbatimin e këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Autoritetin e Aviacionit Civil, me datë 14.12.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 8045/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit me numër Ref:63/2022 dhe numër protokollit 2022/ZDP/361 të datës 21.11.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil, me, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës administrative dhe shkelje të dispozitave të ligjit material, dhe se vendim si i tillë është nxjerrë në kundërshtim me Ligjin nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për shkak se ankuesit i është bërë ulja në pozitë nga "Zyrtar i lartë për bashkëpunim ndërkombëtar", në pozitë "Zyrtar për bashkëpunim ndërkombëtar", dhe këto veprime pretendon se janë bërë për shkak se ankuesi është anëtar i kryesisë së Sindikatës, veprime këto të marra pasi që është zbatuar Vendimi Anr.703/2022 i datës 26.09.2022 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër protokollit 5685/2022, sipas Vendimit Nr.Ref.55/2022 të datës 04.10.2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me date 13.01.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Autoriteti i Aviacionit Civil, ndërsa me datë 24.01.2023 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga ky institucion së bashku me provat e lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me date 25.01.2022 ka nxjerrë Vendimin me numer VK/2023 me të cilin i është vazhduar afati i ankesës edhe dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 8045/2022 të datës 14.12.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin me numër Ref:63/2022 i Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, i datës 21.11.2022; Vendimin me numër Ref: 34/2022 e Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, i datës 25.07.2022 me numër protokollit 2002/ZDP/204, për zbatimin e vendimit të KPMSHCK-së Anr.57/2014; Akt emërimi Nr.01/2022 i datës 29.07.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore në AAC-së; Vendimin Anr.703/2022 të datës 26.09.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër protokollit 5685/2022; Vendimin me numër Ref:55/2022 i Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, i datës 04.10.2022 me numër protokollit 2002/ZDP/308, për zbatimin e vendimit Anr.703/2022 të KPMSHCK-së; Akt emërimi Nr.02/2022 i datës 30.11.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore në AAC-së; Përgjigje në ankesë e datës 24.01.2023 me nr.protokollit 745/2023 nga Njesisë së Burimeve Njerëzore në AAC-së; Vendimi i datës 30.04.2013 lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së nr. Ref.AACK/ADM/BNJ/01-2013, autorizimi për përgatitjen e akt emërimit; Akt emërimi i datës 30.04.2013 të Drejtorit të Përgjithshëm në AAC-së, me përshkrim të detyrave të punës të datës 13.06.2017; Akt emërimi i datës 17.07.2012 të Drejtorit të Përgjithshëm në AAC-së, me përshkrim të detyrave të punës të datës 03.04.2013.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se ankesa e ankuesit *është e bazuar, SEPSE:*

Nga administrimi i provave të lëndës Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesi në bazë të Akt-it të Emërimit të datës 17.07.2012 ka themeluar marrëdhënie të punës në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës, në pozitën "Zyrtar për Bashkëpunim Ndërkombëtar", ndersa pas procedurës së avancimit të shpallur me datë 04.05.2013 dhe Vendimit Ref.nr.AACK/ADM/BNJ/01-2013 të datës 30.04.2013 të Drejtorit të Përgjithshme të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës ankuesi është përzgjedhur në pozitën *Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Ndërkombëtar*, duke ju lëshuar edhe Akti i Emërimit i datës 30.04.2013, dhe nga kjo procedurë e rekrutimi-avancimit nuk ka pasur ankesë të ushtruar ndaj avancimit mirepo Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në kuadër të ushtrimit të funksionit të tij kushtetues dhe ligjor, gjegjësisht me rastin monitorimit të rregullt në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës për vitin 2013, ka konstatuar se procedura e avancimit e shpallur me datë 04.05.2013 për pozitën *Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Ndërkombëtar*" është zhvilluar në kundërshtim me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr. 21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve civil, fakt ky i konstatuar si e gjetur me shenjen 5 në Raportin e Monitorimit të miratuar përmes Vendimit Nr. 57/2014 të datës 2014 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës më datë 25.07.2022 ka nxjerrë Vendimin Nr.Ref:34/2022, më të cilin në pikën I të dispozitivit ka vendosur lidhur me zbatimin Vendimit me Nr. 57/2014 të datës 26.12.2014 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përkitazi më të gjeturën dhe rekomandimin 5 të Raportit të Monitorimit të vitit 2013, ndërsa në pikën II të diapozitivit ka anuluar Vendimin Ref:AACK/ADM/BNJ/01-2013 të datës 30.04.2013 me të gjitha pasojat juridike përshirë ndryshimin në gradën dhe pagës dhe ka obliguar Njësinë e Burimeve Njerëzore të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës që të bëjë ndryshim dhe plotësim të Akt-it të emërimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendimin me numer Anr.703/2022 të datës 26.09.2022, e ka aprovuar ankesën e datës 12.08.2022 të ankuesit

për çështjen juridike kërkesë nga marrëdhënia e punës, duke anuluar Vendimin me numër protokolli 2022/ZDP/204 të datës 25.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm në Autoritetin e Aviacionit Civil, dhe çdo vendim tjetër administrativ i pasuar si rrjedhojë e këtij vendimi, duke obliguar Drejtorin e Përgjithshëm në Autoritetin e Aviacionit Civil, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të kthejë ankuesin në vendin e punës sipas Akt-it të Emërimit të datës 30.04.2013, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës si dhe të bëjë kompensimin e diferencës së pagës nga data 25.07.2022 deri në zbatimin e këtij vendimi. Organi i punesimit pasi ka pranuar këtë vendim me datë 04.10.2022 ka nxjerrë Vendimin me numër Nr.Ref.55/2022 të protokolluar me numër 2022/ZDP/308, për zbatimin e Vendimit të Këshillit Anr.703/2022, duke anuluar Vendimin me numër protokolli 2022/ZDP/204 të datës 25.07.2022, dhe rikthen në fuqi Akt emërimin e datës 30.04.2023, duke kompensuar

diferencën e pagës nga zbatimi i vendimit Nr. Ref.34/2022 dhe obligon Njësinë e Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi, duke vepruar në bazë të kompetencës ligjore të përcaktuar në nenin 21 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Tutje me datë 21.11.2022 Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin Nr. Ref: 63/2022 me të cilin në pikën I të dispozitiv ka anuluar Vendimin me numër Ref: AACK/ADM/BNJ/01-2013 të datës 30.04.2013, duke perfshi edhe ndryshimin në gradë dhe pagë për ankuesin pas përfundimit të procedurës së avancimit në pozitë "Zyrtar i lartë për bashkëpunim ndërkombëtar", dhe pikën II ka obliguar Njësinë e Burimeve Njerëzore për zbatimin e vendimit për ndryshimin e akt emërimit dhe gradës së pagës, duke vendosur në bazë të Vendimit me numër Anr.57/2014 të datës 26.12.2014 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Ankuesi me datë 14.12.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 8045/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit me numër Ref:63/2022 dhe numër protokolli 2022/ZDP/361 të datës 21.11.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës administrative dhe shkeljeve të dispozitave të ligjit material.

Kolegji i Këshillit, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër Ref:63/2022, me numër protokolli 2022/ZDP/361 të datës 21.11.2022, është bërë me shkelje të dispozitave ligjore të procedurës administrative dhe shkelje të ligjit material, respektivisht vendimi i nxjerrë është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe në kundërshtim me zbatimin e Vendimin Anr.703/2022 të datës 26.09.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe ka konststuar se pretendimet ankimore te ankuesit jane të bazuara sepse në pikëpamje të ligjshmërisë së Vendimit me numër Ref:63/2022, me numër protokolli 2022/ZDP/361 të datës 21.11.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i aplikueshëm në kohën e nxjerrjes së vendimit të kundërshtuar me ankesë përkatësisht:

Nenin 51 ku përcaktohet se: *Një akt administrativ fillon të prodhojë pasojat juridike në raport me palën të cilës i drejtohet apo e cila cenohet nga ai, me njoftimin e përmbajtjes të tij...4. Një akt administrativ do të prodhojë pasoja juridike për at kohë sa nuk është anuluar apo shfuqizuar sipas detyrës zyrtare apo si rezultat i ushtrimit të mjeteve juridike administrative apo gjyqësore, nuk skadon për arsye të kohës apo përmbushjes së qëllimit të tij, apo nuk pushon së prodhuari të pasojave, për çfarëdo arsye tjetër të paraparë me ligj.*

Nenin 53 sipas të cilit: *1. Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që ka kompetenca të nxjerrë aktin, nga organi i tij mbikëqyrës apo nga një organ tjetër i përcaktuar shprehimisht me ligj. 2. Anulimi i një akti administrativ ka pasoja në të kaluarën (retroaktive), ndërsa shfuqizimi i aktit administrativ ka pasoja vetëm në të ardhmen. Anulimi edhe shfuqizimi mund të jenë të pjesshëm apo të tërësishëm. 3. Anulimi apo shfuqizimi bëhen me një akt të ri me shkrim, i cili anulon, shfuqizon, ndryshon apo plotëson aktin e parë.*



Nenin 144 ku përcakton se: " 1.Një akt administrativ do të bëhet i ekzekutueshëm me: 1.1. skadimin e afatit për ankesën kundër tij, nëse një ankesë e tillë nuk është parashtruar;1.2. njoftimin e palës, me aktin, kur sipas ligjit, nuk lejohet ankesa, 1.3. njoftimin e palës me aktin, kur, sipas ligjit, ankesa nuk ka efekt pezullue.1.4. njoftimin e palës me aktin e ndalimit të efektit pezullues të ankesës, në pajtim me paragrafin 3 të nenit 130 të këtij Ligji, apo 1.5. njoftimin e palës për refuzimin e ankesës.2. Akti i zgjidhjes së ankesës që ndryshon një akt administrativ të ankimuar, bëhet i ekzekutueshëm me njoftimin e palës.3. Akti administrativ nuk mund të ekzekutohet nëse kanë kaluar pesë (5) vite nga koha kur akti administrativ është bërë i ekzekutueshëm dhe nuk është ndërmarrë asnjë veprim ekzekutimi, apo kanë kaluar 3 (tre) vite nga veprimi i fundit për ekzekutimin, prandaj duke u nisur nga fakti se Drejtori i Përgjithshëm në Autoritetin e Aviacionit Civil, në vendimin e atakuar me numër Ref.63/2022 të datës 21.11.2022, në pikën I të dispozitiv ka anuluar Vendimin me numër Ref: AACK/ADM/BNJ/01-2013 të datës 30.01.2013, duke përfshirë edhe ndryshimin e gradës në pagë për ankuesin dhe pikën II ka obliguar Njësinë e Burimeve Njerëzore për zbatimin e vendimit për ndryshimin e akt emërimit dhe gradës së pagës duke u bazuar në Vendimin Anr.57/2014 të datës 26.12.2014 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës gjegjësisht sipas sipas Raportit të monitorimit për vitin 2014, andaj Kolegji i Këshillit konstaton së ekzekutimi i Vendimit Nr.57/2014 i datës 26.12.2014 përmes vendimit të kontestuar është bërë pas kalimit të afatit ligjor për ekzekutim rrjedhimisht në kundërshtim me dispozitat e parashkrimit ligjor lidhur me ekzekutimin e aktit administrativ të përcaktuara me nenin 144 paragrafi 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse nga administrimi i shkresave të lëndës nuk rezulton të jetë ndërmarr ndonjë veprim ligjore për ekzekutim (vullnetar apo të detyrueshëm) apo kundërshtim të Vendimit të Këshillit Nr.57/2014 të datës 26.12.2014.

Kështu që mbi bazën e këtyre rrethana ligjore dhe gjendjen e konstatuar faktike Kolegji vlerëson së Vendimi i atakuar me numër Ref.63/2022 i datës 21.11.2022, i nxjerrë mbi bazën e zbatimit të Vendimi i Këshillit Nr.57/2014 të datës 26.12.2014 është ligjërish i pa bazuar dhe në shpërputhje me parimin e sigurisë juridike ashtu siç e ka konstatuar edhe Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendimin me numer Anr.703/2022 të datës 26.09.2022, me të cilin e ka anuluar edhe Vendimin me numër protokollit 2022/ZDP/204 të datës 25.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm në Autoritetin e Aviacionit Civil.

Nisur nga konstatimi së vendimi i kundërshtuar me ankesë është i përfshirë më shkelje të dispozitave materiale, Kolegji i Këshillit konstaton së një akt administrativ i nxjerrë në kundërshtim më ligjin material është akt i paligjshëm në vështrim të nenin 52 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5 të të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe si i tillë nuk prodhon asnjë pasojë juridike, kështu që për këto arsye rrjedhë së janë të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit.

Duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura nga palët në procedurë, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër: A.nr.1187/2022

Zyle Millaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil;
- Udhëheqësit të Personelit në Autoritetin e Aviacionit civil dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.